

VENDIM
Nr. 619, datë 29.7.2020

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I HAPËSIRËS SË VARREZAVE”, NË FSHATIN ÇERMË E SIPËRME, NJËSIA ADMINISTRATIVE TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i hapësirës së varrezave”, në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Divjakë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “tokë arë”, me vlerë të përgjithshme prej 2 147 600 (dy milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, me vlerë prej 2 147 600 (dy milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2020, i miratuar për Bashkinë Divjakë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Divjakë.

8. Bashkia Divjakë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Divjakë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Divjakë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Divjakë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarit të pasurisë, pronë private, që preket nga realizimi i projektit:
 “Zgjerimi i hapësirës së varrezave”, në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqja “tokë arë” (m ²)	Çmimi i “tokë arë” (lekë/m ²)	Vlera totale (lekë)	Shënime konfirmuar nga ZVRPP-ja
1	138 1	200/50	Fshati Çermë e Sipërme	Selman Hekuran Hoxha	5900	364	2,147,600	Kërkesë nr. 576 prot..., datë 6.2.2020; kthim përgjigje nr. 1550/1 prot., datë 10.2.2020, protokolluar nga Bashkia Divjakë me nr. 576/1, datë 11.2.2020.
Total							2,147,600	

Shënime:

- Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.